



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KORÇË
KËSHILLI BASHKIAK**

P/V E N D I M

Nr. _____ datë _____ 2023

PËR

“MIRATIMIN PËR VËNIEN NË DISPOZICION TË PROJEKTIT, SIPAS VKM-SË NR.17, DATË 18.1.2023, PËR ZHVILLIMIN E PRONËS ME NR. PASURIE 1/5, ZONA KADASTRALE 8561, E LLOJIT “TERREN SPORTIV”, ME SIP 23934.7 M²; TË PRONËS ME NR. PASURIE 1/12, ZONA KADASTRALE 8561, E LLOJIT “TRUALL”, ME SIP. 2974.5 M²; TË PRONËS ME NR. PASURIE 1/912, ZONA KADASTRALE 8561, E LLOJIT “TRUALL”, ME SIP 85836 M²; NË PRONËSI TË BASHKISË KORÇË DHE MIRATIMIN E MARRËVESHJES PËR ZHVILLIMIN E PROJEKTIT TË ZONËS MULTIFUNKSIONALE PËRRETH KOMPLEKSIT TË STADIUMIT “SKËNDERBEU” NË KORÇË, PËRFSHIRË STADIUMIN, QË DO TË NËNSHKRUHET MIDIS MINISTRISË SË ARSIMIT DHE SPORTIT, BASHKISË KORÇË, AGJENCISË KOMBËTARE TË PLANIFIKIMIT TË TERRITORIT SI DHE FONDIT SHQIPTAR TË ZHVILLIMIT”

Në mbështetje të Ligjit 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” të ndryshuar; Ligjit 102/2020 “Për zhvillimin rajonal dhe kohezionin”; ligji 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”; ligji 79/2017 “Për sportin”; VKM nr.17 date 18.01.2023 “Për ngarkimin e Agjencisë Kombëtare të Planifikimit të Territorit, si organ qendror blerës, për realizimin e konkursit të projektimit për projektidetë e rikonceptimit të komplekseve sportive të stadiumeve në qytetet e Durrësit, Korçës dhe Vlorës”; VKM 1532 date 19.11.2008 “Përmiratimin e listëspërfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen, në pronësi ose në përdorim, të Bashkisë Korçë të Qarkut të Korçës” si dhe në vijim të relacionit të përgatitur nga Drejtoria e Pergjithshme Juridike dhe Drejtoria e Planifikimit Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit; me propozim të Kryetarit të Bashkisë:

KESHILLI BASHKIAK

V E N D O S I

1. Miratimin për vënien në dispozicion të projektit, sipas VKM-së nr. 17, datë 18.1.2023, të pronës me nr. pasurie 1/5, zonë kadastrale 8561, e llojit “terren sportiv”, me sip. 23934.7m²; të pronës me nr. pasurie 1/12, zonë kadastrale 8561, e llojit “truall”, me sip. 2974.5 m²; të pronës me nr. pasurie 1/912, zonë kadastrale 8561, e llojit “truall”, me sip. 85836 m², në pronësi të Bashkisë Korçë, sipas certifikatës së pronësisë të Bashkisë Korçë, lëshuar nga ASHK, Drejtoria Vendore Korçë.
2. Miratimin e marrëveshjes për zhvillimin e projektit të zonës multifunktionale përreth kompleksit të stadiumit “Skënderbeu” në Korçë përfshirë stadiumin, që do të nënshkruhet midis Ministrisë së Arsimit dhe Sportit (MAS), Bashkisë Korçë, Agjencisë Kombëtare të Planifikimit të Territorit (AKPT) dhe Fondit Shqiptar të Zhvillimit (FSHZH), sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.
3. Ngarkohet Kryetari i Bashkisë për nënshkrimin e Marrëveshjes midis Bashkisë Korçë, MAS, AKPT dhe FSHZH.
4. Ngarkohen Kryetari i Bashkisë, Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit, Drejtoria e Pergjithshme Juridike dhe e Menaxhimit të Burimeve Njerezore, për zbatimin e këtij vendimi.
5. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar.

Sekretari i Këshillit Bashkiak **K R Y E T A R**

Eva NAÇI

ANA VERUSHI

Miratuar me _____ vota

Vota Pro _____

Vota Kundër _____

Vota Abstenim _____

Zbardhur më datë _____